



V E N D I M

K.P.P 607/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik, “*Trinity Trade Company*” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr. REF-72902-05-31-2018, me objekt: “*Blerje vula për matësat e abonentëve*”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 14.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Sarandë.

Ankimues:

“*Triniy Trade Company*” sh.p.k
Rr “Reshit Çollaku”, Ndërtesa 38 (P-15 katësh), H.6, Ap.3
Njësia Administrative Nr.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Sarandë.
Gjashtë-Sarandë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimueit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimueit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 01.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr. REF-72902-05-31-2018, me objekt: “*Blerje vula për matësat e abonentëve*”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 14.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Sarandë.

II.2. Në datën 14.06.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 21.06.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Muça” shpk	pa ofertë	skualifikuar
2. “Alfat” shpk	550.000 lekë	skualifikuar
3. “Trinity Trade Company” shpk	612.000 lekë	skualifikuar
4. “Hidro Mentori” shpk	700.000 lekë	skualifikuar
5. “A.M.U” shpk	895.000 lekë	skualifikuar

II.4. Operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k është njoftuar më datë 21.06.2018 lidhur me klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me pretendimin si më poshtë:

“Pikat 2.3.1, Operatori nuk ka paraqit raport testimi nga institucione të akredituara”.

II.5. Në datën 28.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

Autoriteti kontraktor Ujësjiellës-Kanalizime sh.a Sarandë, më datë 14.06.2018, ka zhvilluar tenderin e hapur me objekt prokurimi: “Blerje vula për matësas e abonentëve”, me fond limit: 1,000,000 (një milion) lekë pa tvsh.

Shoqëria “Trinity Trade Company” shpk ka marrë pjesë në këtë garë, duke dërguar ofertën e saj dhe dokumentat shoqëruese, nëpërmjet SPE, sipas kërkesave të DT, LPP dhe VKM- se per RRPP.

Më datë 21.06.2018, nëpërmjet SPE, na vijnë 2 mesazhet e KVO- së, së autoriteti kontraktor-Ujësjiellës-Kanalizime sh.a Sarandë.

Nëpërmjet mesazhit të parë njoftohemi për klasifikimin e ofertuesve, si më poshtë:

<i>Operatoret ekonomike</i>	<i>Vlerat e Ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>“Alfat” shpk</i>	<i>550000.00</i>	<i>Po</i>
<i>“Trinity Trade Company” shpk</i>	<i>612000.00</i>	<i>Po</i>
<i>“Hidro Mentori” shpk</i>	<i>700000.00</i>	<i>Po</i>
<i>“A.M.U” shpk</i>	<i>895000.00</i>	<i>Po</i>

Nëpërmjet mesazhit të dytë njoftohemi për arsyen e refuzimit, që sipas KVO-së përkatesë është:

“Pikat 2.3.1, Operatori nuk ka paraqit raport testimi nga institucione të akredituara”.

Ne si kompani ofertuese, duke qënë të bindur në ofertën tonë, e cila është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentat shoqëruese të saj, të cilët janë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe ligjin jemi të bindur në gabimin (lapsusin) ose shkeljen e ligjit nga ana e KVO-së për skualifikimin tone po bëjmë këtë ankesë, fillimisht drejtuar autoritetit kontraktor.

Përsa i përket arsyes së skualifikimit sqarojmë:

Në dokumentat e tenderit me objekt prokurimi: “Blerje vula për matësas e abonentëve”, kërkesat për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institution të akredituar”

Si dhe më poshtë kërkohet: “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat e mëposhtme të prodhuesit:

EN ISO 9001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent”.

EN ISO 14001 “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent”.

2.3.4 Nëse operatori ekonomik furnizohet nga një operator tjetër (prodhues), do të paraqesë autorizim ose kontratë (distributori) të furnizimit me shkrim, të konfirmuar nga prodhuesi. Ndërsa, po të shohim specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, në to ka vetëm përshkrim fizik për plumbçet dhe nuk ka tregues fiziko-mekanik sipas të cilëve mund të krahasohen treguesit e kërkuar me ato që duhet të pasqyrohen në dokumentin e testimit!!

Megjithatë:

Shoqëria jonë, në plotësim të këtyre kërkesave ka paraqitur dokumentin me emërtimin “15-Dokumentacion teknik” në brendësi të së cilit ndodhen të gjithë dokumentat e kërkuara më sipër. Përsa i përket pretendimit të KVO-së, se operatori ekonomik nuk ka paraqitur raport testimi nga institution të akredituar, sqarojme se:

Në faqet 7-10 të dokumentit të paraqitur me emërtimin “15-Dokumentacion teknik”, ndodhet “Çertifikata e konformitetit CE”, e cila tregon që artikulli “Plumbçe për matësat”, të cilin e kemi ofruar në ofertë është i testuar dhe i analizuar nga institucione të akredituara, siç është “BRITISH CERTIFICATION INC” dhe pas këtij testimi kjo plumbçe rezulton konform standartit CE.

Raporti i testimit nga një laborator për treguesit bëhet në funksion të një standarti të caktuar dhe në varësi të këtij raporti ky produkt çertifikohet ose jo.

I kujtojmë anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), se Çertifikata CE, e sipërpërmendur dhe e paraqitur nga ana jonë në plotësim të kërkesës për raport testimi është një dokument shumë herë më i vlefshëm dhe më i saktë sesa një raport testimi nga një laborator i thjeshtë qoftë edhe i akredituar vendas apo i huaj.

Një produkt i çertifikuar me CE përfaqson dhe tregon cilësinë më të lartë të këtij produkti.

Të nderuar anëtarë të (KSHA), këto fakte mund ti verifikoni shumë thjesht, duke eksploruar sado pak në internet, në lidhje me rëndësin e Çertifikatës CE.

Bashkëngjitur në këtë dokumentacion është dhe katalogu i produktit me të dhënat teknike, model klasik, standart.

Gjithashtu, së bashku me ofertën shoqëria jonë ka paraqitur edhe “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”, të detyrueshme për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të dokumentave të tenderit dhe që rezulton e fimosur nga ana e administratorit, si angazhim konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të krijojnë bindjen dhe garancinë për realizimin e kontratës.

Me dokumentacionin e paraqitur shoqëria jonë plotëson dhe tejkalon të gjitha kriteret e dokumentave të tenderit, duke krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor për realizimin me sukses të kontratës sipas specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në kohën e caktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, kërkuam nga titullari i autoritetit kontraktor, nëpërmjet KSHA, verifikimin edhe një herë të dokumentave të ofertës, dhe zbatimin e LPP, duke rrëzuar edhe pretendimin e KVO-së në lidhje me ofertën tonë, si lapsus apo shkelje e ligjit nga ana e KVO- së përkatëse.

Në funksion të qëllimit kryesor i cili është realizimi i kontratës me cilësi, autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë edhe frymën e LPP.

Pra, nisur nga tërësia e dokumentave që ka paraqitur shoqëria jonë si dhe nga fryma e LPP, dhe VKM-së për RRPP, konkludojmë që oferta jonë duhet pranuar nga autoriteti kontraktor.

1-Anullimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë sonë, duke e shpallur atë të kualifikuar.

II.6. Në datën 29.06.2018, me shkresën nr.479 prot, operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor me pretendimin si më poshtë:

Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, bazuar në vendimin e titullarit të autoritetit kontraktor datë 29.06.2018 “Për krijimin e komisionit për shqyrtimin e ankesës” të paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt : “Blerje vula për matësat e abonentëve”, me fondi limit 1.000.000 (njëmilion) lekë pa tvsh, po ju paraqesim vendimin e mëposhtëm të marrë nga ana jonë pas shqyrtimit të dokumentacionit.

Në pikën 2.3.1 të dokumentave të tenderit për procedurën “Blerje vulash për matësa” thuhet që: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institution të akredituar”

Operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, ka paraqitur për procedurën në fjalë Çertifikatën e Konformitetit CE, e cila paraqet, sipas një kërkimi të thjesht në internet, vulën e përshtatshmërisë, sigurisë, dhe mbrojtjen e standarteve mjedisore për produktet që shiten në territorin e Bashkimit European.

Pra vula CE tregon që produkti i prodhuar është në përputhje me direktivat dhe standartet e prodhimit në Bashkimin European, por kjo vulë nuk tregon cilësinë më të lartë të produktit, sepse plotësimi i standartit CE nuk është treguesi më i mirë i cilësisë së produktit në botë.

Duke ju konfirmuar dhe njëherë se çertifikata e konformitetit CE janë garante për arritjen e minimumit të gjitha rregullave, sigurisë dhe kërkesave teknike për territorin e Bashkimit European, por jo garante për arritjen e cilësisë më të lartë të produktit siç pretendohet nga kompania ankuese “Trinity Trade Company” shpk.

Raporti i testimit jep vlera konkrete se sa produkti i kërkuar është në përputhje jo vetëm me standartet Europiane, por më a rëndësishmja është se sa ky produkt i kërkuar arrin qasjen e testimit sipas standartit ndërkombëtar ISO.

Ne si komision i shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave në bazë të këtyre të dhënave vendosim që: “Ankesa e operatorit “Trinity Trade Company” shpk” nuk qëndron, pasi nga argumentat e mësipërme, operatori ekonomik nuk e plotëson Pikën 2.3.1 sipas DST-së të kërkuar.”.

II.7. Po më datë 29.06.2018, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e ankesës së operatorit ekonomik “A.M.U” shpk, pas pranimit të ankesës së paraqitur prej tij më datë 23.06.2018, si më poshtë:

1. “Muça” shpk	pa ofertë	skualifikuar
2. “Alfat” shpk	550.000 lekë	skualifikuar
3. “Trinity Trade Company” shpk	612.000 lekë	skualifikuar
4. “Hidro Mentori” shpk	700.000 lekë	skualifikuar
5. “A.M.U” shpk	895.000 lekë	kualifikuar

II.8. Në datën 06.07.2018, pala ankimuese “Trinity Trade Company” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke zgjeruar objektin e ankesës, por duke mbajtur të njëjtin pretendim si në ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, si më poshtë:

Autoriteti kontraktor Ujësjiellës-Kanalizime sh.a Sarandë, më datë 14.06.2018, ka zhvilluar tenderin e hapur me objekt prokurimi: “Blerje vula për matësat e abonentëve”, me fond limit: 1,000,000 (një milion) lekë pa tvsh.

Shoqëria “Trinity Trade Company” shpk ka marrë pjesë në këtë garë, duke dërguar ofertën e saj dhe dokumentat shoqëruese, nëpërmjet SPE, sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, ligjit për prokurimin publik dhe rregullave për prokurimin publik.

Më datë 21.06.2018, nëpërmjet SPE, na vijnë mesazhet e KVO-së se autoriteti kontraktor Ujësjiellës-Kanalizime sh.a Sarandë, nëpërmjet të cilëve njoftohemi për klasifikimin e ofertuesve, ku shohim që oferta e shoqërisë tonë është refuzuar, si më poshtë:

Operatorët ekonomike	Vlerat e Ofertuara	Refuzuar
“Muca” shpk	pa vlerë oferte	Po
“Alfat” shpk	550000.00	Po
“Trinity Trade Company” shpk	612000.00	Po
“Hidro Mentori” shpk	700000.00	Po
“A.M.U” shpk	895000.00	Po

Si dhe njoftohemi për arsyen e refuzimit, që sipas KVO-së përkatesë është:

“Pikat 2.3.1, Operatori nuk ka paraqit raport testimi nga institucione të akredituara”.

Ne si kompani ofertuese, duke qënë të bindur në ofertën tonë, e cila është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentat shoqëruese të saj, të cilët janë në përputhje me DT dhe Ligjin, jemi të sigurt se KVO-ja është nxituar dhe ka gabuar në vlerësimin e ofertës tonë, duke shkelur Ligjin.

Më datë 22.06.2018, kemi dërguar ankesën drejtuar titullarit të autoritetit kontraktor, ankesë e cila është marrë në dorëzim nga përfaqësuesi i autoritetit kontraktor me datë 26.06.2018, panvarësisht se autoriteti kontraktor pretendon se është marrë më datë 28.06.2018, (shih dokumentin e postës të

firmosur) me anë të së cilës kërkua rishikimin dhe ndryshimin e vendimit të KVO-së dhe shpalljen e ofertës tonë të kualifikuar.

Më datë 29.06.2015, nëpërmjet email-it, na vjen përgjigjja nga autoriteti kontraktor, sipas së cilës ankesa jonë nuk pranohet!!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik për sa i përket arsyes së skualifikimit sqarojmë:

Në dokumentat e tenderit me objekt prokurimi: “Blerje vula për matësat e abonentëve”, kërkesat për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institucion të akredituar”

Si dhe më poshtë kërkohet: “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat e mëposhtme të prodhuesit:

EN ISO 9001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent”.

EN ISO 14001 “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent”.

2.3.4 Nëse operatori ekonomik furnizohet nga një operator tjetër (prodhues), do të paraqesë autorizim ose kontratë (distributori) të furnizimit me shkrim, të konfirmuar nga prodhuesi.

Ndërsa, po të shohim specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, në to ka vetëm përshkrim fizik për plumbçet dhe nuk ka tregues fiziko-mekanik sipas të cilëve mund të krahasohen treguesit e kërkuar me ato që duhet të pasqyrohen në dokumentin e testimit!!

Megjithatë shoqëria jonë, në plotësim të këtyre kërkesave ka paraqitur dokumentin me emërtimin “15-Dokumentacion teknik” në brendësi të të cilit ndodhen të gjithë dokumentat e kërkuara më sipër.

Për sa i përket pretendimit të KVO-së, se operatori ekonomik nuk ka paraqitur raport testimi nga institucion të akredituar, sqarojmë se:

Në faqet 7-10 të dokumentit të paraqitur me emërtimin “15-Dokumentacion teknik”, ndodhet “Çertifikata e konformitetit CE”, e cila tregon që artikulli “Plumbçe për matësat”, të cilin e kemi ofruar në ofertë është i testuar dhe i analizuar nga institucione të akredituara, siç është “BRITISH CERTIFICATION INC” dhe pas këtij testimi kjo plumbçe rezulton konform standartit CE.

Raporti i testimit nga një laborator për treguesit bëhet në funksion të një standarti të caktuar dhe në varësi të këtij raporti ky produkt certifikohet ose jo.

I kujtojmë anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), se Çertifikata CE, e sipërpërmendur dhe e paraqitur nga ana jonë në plotësim të kërkesës për raport testimi është një dokument shumë herë më i vlefshëm dhe më i saktë sesa një raport testimi nga një laborator i thjeshtë qoftë edhe i akredituar vendas apo i huaj.

Një produkt i certifikuar me CE, përfaqson dhe tregon cilësinë më të lartë të këtij produkti.

Të nderuar anëtarë të (KSHA), këto fakte mund ti verifikoni shumë thjesht duke eksploruar sado pak në internet, në lidhje me rëndësinë e Çertifikatës CE.

Bashkëngjitur në këtë dokumentacion është dhe katalogu i produktit me të dhënat teknike, model klasik, standart.

Gjithashtu, së bashku me ofertën shoqëria jonë ka paraqitur edhe “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”, të detyrueshme për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të dokumentave të tenderit dhe që rezulton e fimosur nga ana e administratorit, si angazhim konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të krijojnë bindjen dhe garancinë për realizimin e kontratës.

Me dokumentacionin e paraqitur shoqëria jonë plotëson dhe tejkalon të gjitha kriteret e dokumentave të tenderit, duke krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor për realizimin me sukses të kontratës sipas specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në kohën e caktuar në dokumentat e tenderit.

Në funksion të qëllimit kryesor i cili është realizimi i kontratës me cilësi, autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë edhe frymën e LPP.

Pra, nisur nga tërësia e dokumentave që ka paraqitur shoqëria jonë si dhe nga fryma e LPP, dhe VKM-së për RRPP, konkludojmë që oferta jonë duhet pranuar nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, kërkuam nga titullari i autoritetit kontraktor, nëpërmjet KSHA, verifikimin edhe një herë të dokumentave të ofertës, dhe zbatimin e LPP, duke rrëzuar edhe pretendimin e KVO-së në lidhje me ofertën tonë, si lapsus apo shkelje e Ligjit nga ana e KVO- së përkatëse.

Prandaj në bazë të LPP dhe VKM për RRPP, kërkuam nga Titullari i autoritetit kontraktor: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së, për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Trinity Trade Company” shpk, duke e shpallur atë të kualifikuar.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, për ankesën tonë shohim:

Autoriteti kontraktor, ndër të tjera ka theksuar:

“Duke ju konfirmuar dhe njëherë se çertifikata e konformitetit CE janë garante për arritjen e minimumit të gjitha rregullave, sigurisë dhe kërkesave teknike për teritorin e Bashkimit Europian, por jo garante për arritjen e cilësisë më të lartë të produktit siç pretendohet nga kompania ankuese “Trinity Trade Company shpk”.

Raporti i testimit jep vlera konkrete sesa produkti i kërkuar është në përputhje jo vetëm me standartet europiane, por më e rëndësishmja është se sa ky produkt i kërkuar arrin qasjen e testimit sipas standartit ndërkombëtar ISO.

Sqarojmë duke e kundërshtuar këtë interpretim të autoritetit kontraktor:

Referuar kërkesës përkatëse tek “Kërkesat e veçanta për kualifikim”, pika 2.3.1: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institution i akredituar”.

Shoqëria “Trinity Trade Company” shpk ka ofruar Çertifikatë Konformiteti CE, dokument që është në një shkallë më të lartë në lidhje me elementët e sigurisë.

Çfarë është një Çertifikatë Konformiteti CE?

Çertifikata e Konformitetit CE nuk është certifikatë e përgjithshme që tregon plotësimin e direktivave dhe standarteve të prodhimit, por është një certifikatë cilësie produkti ku tregohet se produkti plotëson një standart të caktuar dhe plotësimi i këtij standarti është i vërtetuar nga autoritetet kompetente (bashkëngjitur dokumenti).

Të marrësh një Çertifikatë Konformiteti produkti, duhet të kesh dokumentat përkatëse, përfshirë treguesit teknikë, modelet përkatëse nga fabrika dhe raportet e testimit nga laboratorë të njohur dhe mbas verifikimit të tyre, vërtetimit të tyre nesë janë dokumenta të sakta dhe të besueshme lëshohet Çertifikata e Konformitetit.

Thjesht:

Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka kërkuar raport testimi, ndërkohë që ne kemi ofruar raport testimi të vërtetuar (çertifikuar) – (Çertifikatë Konformiteti). Nuk mund të refuzohet një ofertë, e cila ofron mallra më cilësorë se ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor!!!!!!

Referuar katalogut të produktit të paragjitur nga shoqëria “Trinity Trade Company” shpk, në këtë procedurë, theksojmë se: “Në ofertë është paraqitur “Modell PM06” me karakteristikat teknike përkatëse që janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.”.

Nga ana e kompanisë prodhuese për këtë model, si dhe për shumë modele të tjera është aplikuar për pajisjen me Çertifikatë Konformiteti CE.

Pra, është përgatitur dokumentacioni, janë paraqitur treguesit teknike dhe funksional, janë paraqitur raportet e testimit dhe ky model “PM06”, si dhe shumë të tjerë, mbas verifikimit të saktësisë dhe origjinalitetit, janë çertifikuar me Çertifikatë Konformiteti CE.

Në çertifikatën e paraqitur në ofertë duket qartë emërtimi i modelit “PM06”.

Standarti European për një model të caktuar është unik, i vetëm. Nuk ka standarte CE për të njëjtin model me kategori të ndryshme.

E thënë thjesht: për një model ka një standart CE, dmth, nuk ka cilësi të ulët, të mesme, apo të lartë që plotëson të njëjtin standart CE.

Gjithashtu të nderuar anëtarë të KPP-së, në vendimarrjet e autoritetit kontraktor pas përgjigjes ndaj ankesës sonë, shohim edhe shkelje procedurale dhe ligjore:

- duke nisur që nga dhe me riklasifikimin e ri më datë 29.06.2018 ku çuditërisht tek arsyet e skualifikimit tonë, KVO-ja, shkruan përgjigjen e ankesës tonë !!!!. Kjo në kundërshtim me ligjin, pasi KVO-ja, në rastin e riklasifikimit, thjesht duhet të përsëriste të njëjtën arsye të skualifikimit të shoqërisë “Trinity Trade Company” shpk, si herën e parë të klasifikimit (meqënëse ankesa jonë nuk ishte pranuar)

- si dhe, kualifikim të padrejtë të shoqërisë “A.M.U” shpk, pas ankesës së bërë nga ky i fundit, theksojmë në mënyrë elektronike në SPE, dhe jo me shkresë fizike pranë autoritetit kontraktor.

Theksojmë se në klasifikimin e parë të autoritetit kontraktor të datës 21.06.2018, ky operator ekonomik është skualifikuar me të drejtë nga ana e KVO-së, me faktin që Çertifikatat ISO të prodhuesit të paraqitur nga ky operator ekonomik janë të skaduara sepse nuk kanë çertifikimin (vulën) e VIZËS VJETORE.

Çuditërisht autoriteti kontraktor e ka kualifikuar këtë operator ekonomik, duke pranuar ankesën e tij!! I kujtojmë operatorit ekonomik se: “Tek shënimet në fund të Çertifikatave ISO të prodhuesit të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M. U” shpk, në procedurë, thuhet si më poshtë:

-Data e Çertifikimit aktual: 20/12/2017

-Cikli aktual i çertifikimit përfundon në: 19/12/2020, me kusht të vizës vjetore.”.

Kjo vizë vjetore - kusht, nuk përmbushet nga çertifikatat e prodhuesit të paraqitura nga ky operator ekonomik.

Certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik “A.M.U” shpk, nuk janë të rregullta. Detyrimisht ky operator ekonomik nuk duhet të ishte kualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor, me gjithë ankesën bërë pranë këtij autoriteti kontraktor.

Të nderuar anëtarë të KPP-së, e përmendëm këtë fakt më lartë, duke ditur që kjo nuk ka lidhje dhe nuk ndikon në fatin e ankesës tonë, por për të treguar papërgjegjshmërinë apo më tepër korrupsionin e zyrtarëve të Ujësjiellës Kanalizime Sarandë, në kualifikimin e operatorit ekonomik me vlerë në limit të fondit, duke qënë ky operator ekonomik me dokumenta të parregullta.

Kërkojmë:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së, për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Trinity Trade Company” shpk, duke e shpallur atë të kualifikuar.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 539 prot., datë 23.07.2018, protokolluar me tonën me nr. 1236/3 prot, datë 26.07.2018, me objekt “Vënie në dijeni lidhur me procedurën e prokurimit” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankimues se, “Nëpërmjet mesazhit të dytë njoftohemi për arsyen e refuzimit, që sipas KVO-së përketesë është:

“Pikat 2.3.1, Operatori nuk ka paraqit raport testimi nga institucione të akredituara”.

Ne si kompani ofertuese, duke qënë të bindur në ofertën tonë, e cila është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentat shoqëruese të saj, të cilët janë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe ligjin jemi të bindur në gabimin (lapsusin) ose shkëljen e ligjit nga ana e KVO-së për skualifikimin tone po bëjmë këtë ankesë, fillimisht drejtuar autoritetit kontraktor.

Përsa i përket arsyes së skualifikimit sqarojmë:

Në dokumentat e tenderit me objekt prokurimi: “Blerje vula për matësat e abonentëve”, kërkesat për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institution të akredituar”

Si dhe më poshtë kërkohet: “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat e mëposhtme të prodhuesit:

EN ISO 9001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent”.

EN ISO 14001 “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent”.

2.3.4 Nëse operatori ekonomik furnizohet nga një operator tjetër (prodhues), do të paraqesë autorizim ose kontratë (distributori) të furnizimit me shkrim, të konfirmuar nga prodhuesi.

Ndërsa, po të shohim specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, në to ka vetëm përshkrim frizik për plumbçet dhe nuk ka tregues fiziko-mekanik sipas të cilëve mund të krahasohen treguesit e kërkuar me ato që duhet të pasqyrohen në dokumentin e testimit!!

Megjithatë:

Shoqëria jonë, në plotësim të këtyre kërkesave ka paraqitur dokumentin me emërtimin “15-Dokumentacion teknik” në brendësi të së cilit ndodhen të gjithë dokumentat e kërkuara më sipër.

Përsa i përket pretendimit të KVO-së, se operatori ekonomik nuk ka paraqitur raport testimi nga institution të akredituar, sqarojme se:

Në faqet 7-10 të dokumentit të paraqitur me emërtimin “15-Dokumentacion teknik”, ndodhet “Çertifikata e konformitetit CE”, e cila tregon që artikulli “Plumbçe për matësat”, të cilin e kemi ofruar në ofertë është i testuar dhe i analizuar nga institucione të akredituara, siç është “BRITISH CERTIFICATION INC” dhe pas këtij testimi kjo plumbçe rezulton konform standartit CE.

Raporti i testimit nga një laborator për treguesit bëhet në funksion të një standarti të caktuar dhe në varësi të këtij raporti ky produkt çertifikohet ose jo.

I kujtojmë anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), se Çertifikata CE, e sipërpërmendur dhe e paraqitur nga ana jonë në plotësim të kërkesës për raport testimi është një dokument shumë herë më i vlefshëm dhe më i saktë sesa një raport testimi nga një laborator i thjeshtë qoftë edhe i akredituar vendas apo i huaj.

Një produkt i çertifikuar me CE përfaqson dhe tregon cilësinë më të lartë të këtij produkti.

Të nderuar anëtarë të (KSHA), këto fakte mund ti verifikoni shumë thjesht, duke eksploruar sado pak në internet, në lidhje me rëndësin e Çertifikatës CE.

Bashkëngjitur në këtë dokumentacion është dhe katalogu i produktit me të dhënat teknike, model klasik, standart.

Gjithashtu, së bashku me ofertën shoqëria jonë ka paraqitur edhe “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”, të detyrueshme për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të dokumentave të tenderit dhe që rezulton e fimosur nga ana e administratorit, si angazhim konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të krijojnë bindjen dhe garancinë për realizimin e kontratës.

Me dokumentacionin e paraqitur shoqëria jonë plotëson dhe tejkalon të gjitha kriteret e dokumentave të tenderit, duke krijuar bindjen tek autoriteti kontraktor për realizimin me sukses të

kontratës sipas specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në kohën e caktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, kërkuam nga titullari i autoritetit kontraktor, nëpërmjet KSHA, verifikimin edhe një herë të dokumentave të ofertës, dhe zbatimin e LPP, duke rrëzuar edhe pretendimin e KVO-së në lidhje me ofertën tonë, si lapsus apo shkelje e ligjit nga ana e KVO- së përkatëse.

Në funksion të qëllimit kryesor i cili është realizimi i kontratës me cilësi, autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë edhe frymën e LPP.

Pra, nisur nga tërësia e dokumentave që ka paraqitur shoqëria jonë si dhe nga fryma e LPP, dhe VKM-së për RRPP, konkludojmë që oferta jonë duhet pranuar nga autoriteti kontraktor.

1-Anullimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e shoqërisë sonë, duke e shpallur atë të kualifikuar.”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën.8, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika.2.3.1 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport testimi nga institucion të akredituar.”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.), si dhe vetë konfirmimit të operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Autorizim prodhuesi për ofertuesin “Trinity Trade Company” shpk, datë 06.06.2018 nga shoqëria prodhueses e lidhëseve të sigurisë “TEKNIKLAS” Ltd., e përkthyer dhe noterizuar.
- Çertifikatë ISO 9001:2015 e shoqërisë prodhuese “TEKNIKLAS” Ltd., e përkthyer dhe noterizuar..
- Çertifikatë ISO 14001:2004 e shoqërisë prodhuese “TEKNIKLAS” Ltd., e përkthyer dhe noterizuar.
- Deklaratë e konformitetit CE numër U/1753, nga “British Certification” i.n.c, për prodhuesin “TEKNIKLAS OTOMOTIV YEDEK PARÇA PLASTIK YAN SANAYI TICARET” L.t.d, deklarohet se mallrat “Vula sigurie plastike” te prodhuara prej tij dhe konkretisht modelet: PM 01, PM 02, PM 03, PM 04, PM 05, PM 06, PM 07, PM 08, PM 09, PM 10, PM 11, PM 12, PM 13, PM 14 dhe PM 15, plotësojnë Direktivat e Sigurisë së Makinerive 2006/42/EC dhe rregulloret e zbatuara për standartet TS EN 60204-1:2011 e EN 60204-1.
- Skedë teknike për artikullin “Lidhëse me përdredhje”, lloji PM 06, I botuar nën siglën e shoqërisë prodhuese “TEKNIKLAS” Ltd.

III.1.3. Në nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe 2 e Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.. [...]”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 6, gërma “c” e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. [...]”.

III.1.5. Nisur nga sa më sipër konstatuar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k është në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor shprehimisht ka kërkuar raport testimi nga institucion i akredituar. Ndërkohë dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k në funksion të përmbushjes së kriterit sa më sipër, nuk ka paraqitur raport testimi nga institucion i akredituar. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato. Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit e si rrjedhim nuk mund të konsiderohet i vlefshëm në këtë procedurë prokurimi.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.1.7. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

III.1.8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur raport testimi nga një institucion i akredituar në lidhje me furnizimet e kërkuara, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në të cilin përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport

testimi nga institucion të akredituar”. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e një fakti të tillë. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”.

III.1.10. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuesë. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” me Nr. REF-72902-05-31-2018, me objekt: “Blerje vula për matësat e abonentëve”, me fond limit 1.000.000 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 14.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1236 Prot
Datë 06.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha